VENDIM
Nr. 599, datë 9.10.2018

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, zëri "Investime", t'i shtohet fondi prej 95 449 680 (nëntëdhjetë e pesë milionë e katërqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të nevojshme për zbatimin e projekteve "Ngritja dhe funksionimi i sallës operative të komandim-kontrollit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve" dhe "Përmirësimi dhe forcimi i elementeve të sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale 'Jordan Misja'".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, të miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama